



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 93 dt.01.08.1995

**MBI**  
**SHPERNDARJE KONTIGJENT STREHIMI PER NGREHINA**  
**PROVIZORE DHE NDERRIM EMRI NE KONTRATE**

Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot në dt.01.08.1995, pasi shqyrtoi relacionin e mësipërm të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Strehimit) në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.530, dt.17.10.1994, pika.1, Ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992, pika.14, neni.14 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, Vendimit Nr.49, dt.29.01.1993 të K.M. “Për përcaktimin e kritereve të të pastrehëve” pika.1, 2 dhe 3,

**VENDOSI**

1. Qytetarët në pikat 1, 2, 3, 4 të konvikteve të Ndërtimit ti paraqesë së bashku me materialin për kthim në fond banese.
2. Të pajisë me autorizime qytetarët si më poshtë për ndërrim emri në kontratë :
  - 1.Pano Qiricit – për (1+1) në Rr.”H.Cenojmeri” Pall.176, shk.4, ap.46, ti jepet në përdorim edhe dhoma veç kuzhinës, e cila figuron në emër të Llesh Torres, i

cili është në burg, por pa të drejtë privatizimi.

2. Muhamet Pisha – për bodrumin në Rr. ”K.Pezës”, mos miratohet deri në plotësim të dokumentave P.138, shk.4 (2+1).
  3. Gëzim Ruçi – për (1+1) në Rr. ”Labinoti”, Pall.4, shk.4, shtesë dhome (ish gabinë elektrike, i pastrehë).
  4. Ferman Agalliu – të mos miratohet, të paraqitet bashkë me vendimin e kthimit në fond banese (ish konvikti i shkollës së ulët të industrisë).
  5. Andromaqi Çavo me nusen e djalit (Eli Çavo) dhe nipin – për apartamentin në Rr. ”Bul. Shqip. e Re” Pallatet 1 Maji Nr.2, ap.11 (2+1) shtesë një dhomë në kontratë ekzistuese.
3. Ky Vendim të zbatohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Strehimit), Enti Kombëtar i Banesave (Drejtoria Rajonale e Tiranës), Njësia Administrative Nr.2; 5;6 dhe 7.
  4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**